



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 për Themelimin e Mardhënies së Punës dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Mardhënies së Punës në Sektorin Publik si dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.05/2014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011, në përputhje me nenin 14 A të Ligjit Nr. 05/L-035 të datës 25 maj 2015, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224.

**Gjykata Themelore në Ferizaj**

**Shpall:**

**K O N K U R S**

**Nr. 06/2017**

1. **Gjykata Themelore në Ferizaj** ----- Shofer ----- 1 (një) pozitë,
2. **Gjykata Themelore në Ferizaj** ----- Shtëpiak ----- 1 (një) pozitë.

**Pozita Nr.1**

**Titulli i pozitës: Shofer**

**Institucioni: Gjykata Themelore në Ferizaj**

**Koeficienti: 5 (pesë).**

**Kohëzgjatja e Kontratës: Pa afat me orar të plotë**

**Nëpunësi mbikëqyrës: Udhëheqësi i Zyrës për Shërbime të Përbashkëta.**

**Qëllimi i postit:** Bënë ngasjen e veturave të KGJK-së dhe Gjykatave, sipas nevojës bënë edhe bartjen e postës. Vozitë automjetet zyrtare për personalitete të larta të Këshillit gjyqësor dhe gjykatave të të gjitha niveleve.

**Detyrat Kryesore:**

1. Bënë vozitjen e përditshme të veturave dhe eliminon defekte të vogla,
2. Raporton për probleme të ndryshme teknike të veturave,
3. Ndërmerr detyrat të vozitjes siç është kërkuar dhe i realizon ato,
4. Dërgon dhe pranon posten nga institucionet e ndryshme për nevoja të KGJK-së dhe gjykatave,
5. Transporton punëtorët që punojnë në gjykata pas orarit të punës,
6. Përcjell gjendjen e automjetit dhe lajmëron për kohën e regjistrimit dhe sigurimit të tij,
7. Kontrollon shpenzimet e automjetit që përdorë dhe raporton për automjet në bazë të udhëzimeve përkatëse,
8. Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës kur të angazhohet nga mbikëqyrësi.

### **Shkathtësitë e kërkuara:**

- Shkathtësi për ngasje të automjetit dhe njohja e rrugëve të Kosovës ----- e nevojshme,
- Njohja e problemeve të vogla teknike në automjet dhe aftësia për rregullimin e tyre ----- e nevojshme,
- I aftë të përpilojë raport për llogaritjen e shpenzimeve dhe kilometrave të kaluara për automjetin që vozitë dhe të raportojë për të ----- e nevojshme,
- Aftësi të komunikimit me gojë dhe me shkrim ----- e nevojshme dhe
- 1 (një) vit përvojë pune nga natyra e njejtë ----- e nevojshme.

### **Kualifikimet arsimiore dhe profesinale për këtë pozitë:**

1. Shkollë e mesme dhe patentë shoferi valid së paku kategoria “B” ----- e nevojshme.

### **Pozita Nr.2**

**Titulli i pozitës: Shtëpiak**

**Institucioni: Gjykata Themelore në Ferizaj**

**Koeficienti: 5 (pesë).**

**Kohëzgjatja e Kontratës: Pa afat me orar të plotë**

**Nëpunësi mbikëqyrës: Udhëheqësi i Zyrës për Shërbime të Përbashkëta.**

**Qëllimi i postit:** Kryen të gjitha meremetimet riparimet dhe zhvendosjen e të gjitha pajisjeve që është pronë e gjykatës.

### **Detyrat Kryesore:**

1. Siguron të gjitha meremetimet, riparimet si dhe zhvendosjet e të gjitha pajisjeve pronë e gjykatës ose të marra me qira,
2. Mbikëqyrë kontrollimin e ndërtesave dhe pajisjeve për të siguruar funksionim të shpejtë dhe të përshtatshëm të tyre, kryen shërbime si meremetime, riparime të nevojshme dhe përmirësime,
3. Bën mirëmbajtjen e ndërtesave (brenda dhe jashtë), të mobileve, të ngrohjes qendrore dhe të ndryshme, pajiseve elektrike e hidraulike dhe rregullimeve tjera,
4. Nëse ndonjë ndërtim është i nevojshëm shtëpiaku kontakton shërbime (servise) të ndryshme të autorizuara dhe ndihmon në punën e tyre,
5. Përgjegjës për mirëmbajtjen e ndërtesës ofrim të punës cilësore si dhe kryen edhe punë tjera fizike (krahu, dore) sipas nevojës.

### **Shkathtësitë e kërkuara:**

- Të ketë shkathtësi të mira ndërnjerëzore ----- e nevojshme.
- Aftësi themelore në mirëmbajtje të ndërtesave, mekanikë, pajisjeve elektrike, shërbimet komunale dhe të tjera ----- e nevojshme.
- Aftësi që të kryej riparime dhe ndërtime dhe të bëjë lëvizjen apo zhvendosjen e të gjitha pajisjeve që janë pronë e gjykatës ----- e nevojshme.
- Pa përvojë pune.

### **Kualifikimet arsimiore dhe profesinale për këtë pozitë:**

1. Diplomë e shkollës së mesme ----- e nevojshme.

## VEREJTJE:

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në Web portalin e Gjykatës, si dhe në gazetën ditore “Bota Sot”, duke filluar nga data e publikimit më **26.10.2017 deri me datë 09.11.2017** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikimi: Kërkesa ([Aplikacioni](#)) për punësim gjendet në Web portal: [www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org) dhe në Gjykatën Themelore në Ferizaj, dhe pas plotësimit sipas çdo pike të aplikacionit, i bashkangjiteni kopjet e dokumenteve të cilat kërkohen sipas konkursit.

Aplikacionet e plotësuara dorëzohen në adresën: Gjykata Themelore në Ferizaj, Rr.”Dëshmorët e Kombit” pn. 70000, Ferizaj, Kosovë, aplikacionet e dorëzuara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditëve të punës nga dita e dorëzimit në postë. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit duhet t’i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit si në vijim:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor,
2. Dokumentin e identifikimit dhe
3. Certifikata që nuk jeni nën hetime.

Vetëm kandidatët të cilën i plotësojnë kriteret e konkursit do të selektohen për listën e ngushtë dhe do të ftohen në testin me shkrim, ata që kalojnë testin me shkrim do të thirren në intervistë me gojë. Informimi i kandidatëve do të bëhet përmes Web portalit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, telefonit ose email adresës. Kandidatët që ftohen në testimin me shkrim, janë të obliguar që me vete të sjellin dokumentin origjinal për verifikim para Komisionit.

Njoftimet i gjeni web portal, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 0290/ 321 009 nga ora 08:00 – 16:00.

“Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe përkrah aplikimet e femrave dhe meshkujve e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.